



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

HUSEJNI R.A. DËSHMOR I QERBELASË Shevki Muhamed

Botuar në: Dituria Islame

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Bashkim Avdiu

HUSEJNI RADIJELLAHU ANHU – DËSHMOR I QERBELASË.....	4
BIOGRAFIA E HUSEJNIT R.A. – PJESË E HISTORISË ISLAME.....	5
VIRTYTET E HUSEJNIT R. A.....	6
AMANETI I PEJGAMBERIT A.S.	7
EBU-BEKRI, OMERI, OTHMANI DHE ALIU KANË SHFAQUR NDERIMET E THELLA NDAJ FAMILJES SË PEJGAMBERIT A.S.....	8
MUAVIU R.A. KA PASUR RESPEKT TË THELLË PËR HASANIN DHE HUSEJNIN.....	9
HUSEJNI R. A. SI TRANSMETUES I HADITHEVE	10
BANORËT E IRAKUT KËRKOJNË ARDHJEN E HUSEJNIT R.A. NË KUFË.....	11
AS’HABËT MË TË NJOHUR E KËSHILLOJNË HUSEJNIN QË MOS TA LËSHOJË MEKËN	11
HUSEJNI R.A. E DËRGON AXHËN E TIJ NË IRAK	14
IRAKIANËT TRADHTOJNË HUSEJNI DHE SHFAQIN HIPOKRIZINË E TYRE CINIKE	15
VRASJA E HUSEJNIT R.A.....	16
TRANSMETIMET E RREJSHME LIDHUR ME VRASJEN E HUSEJNIT R.A.	16
ÇKA ËSHTË THËNË PËR JEZID IBN MUAVIUN.....	18
HISTORIA E RREJSHME DHE E MVESHUR.....	20
PËRSHKRIMI I HISTORISË ISLAME	24
ÇKA KA NDODHUR NË TË VËRTETË.....	25
REZYMEJA.....	27

HUSEJNI RADIJELLAHU ANHU – DËSHMOR I QERBELASË

Me studimin dhe gjurmimin e së kaluarës njerëzore, historianët e drejtë dhe objektiv, vërejnë se në procedimet, vendimet dhe qëndrimet e personaliteteve dhe prijësve të shquar ka mjaft shembuj të shkëlqyer, të cilët mund të jenë model për popujt e tyre. Ummeti islam gjatë historisë së shkëlqyer të tij, në çdo shekull, ka dhënë mjaft shembuj të heronjëve dhe kolosëve, të cilët në esencë paraqesin rrugën që duhet pasuar. Ska dyshim se në ballë të karavanit historik islam qëndron gjenerata e Pejgamberit a.s., Sahabët r.a. (shokët e tij). Ata kanë qenë dhe kanë mbetur yjet që shndrisin rrugën e udhëzimit hyjnor sepse kanë arritur që plotësisht t'i ndërlihdin parimet islame dhe praktikën efikase të tyre, nga njëra anë, dhe sakrifikimin konstant për qështjen e islamit dhe të njëhjes së shkëlqyer të gjendjes faktike në shoqëri nga ana tjetër. Në këtë drejtim ata janë ballafaquar e sprovuar me metoda të ndryshme të torturimit dhe maltretim, madje shumë nga ata kanë dhënë edhe jetën për islam dhe me këtë kanë arritur gradën më të lartë tek All-llahu xh.sh., kanë rënë shehid (dëshmorë për kauzën e All-llahut). Ky është nderim i veçantë me të cilin All-llahu i Lartëmadhëruar i nderon vetëm ata që Ai i zgjedhë. Omer Ibnul-Hattabi, Othman Ibn Affani, Ali Ibn Ebu-Talibi dhe Husejni, radijellahu anhum, janë ndër Sahabët më të njohur, të cilët janë vrarë tradhëtisht dhe me dredhi nga pabesimtarët, hipokritët dhe mëkatarët e mëdhenj

Husejn Ibn Ali Ibn Ebu-Talibi, nipi i Pejgamberit a.s. (djali i bijës së tij Fatimes) lindi pas të vëllait të tij Hasanit. Ibn-Tejmijje dhe Ibn-Kethiri konsiderojnë se Hasani ka lindur në muajin Ramazan,

në vitin e tretë pas hixhretit, ndërsa Husejni r.a. në muajin Sha'ban në vitin e katërt pas hixhretit (është vrarë me 10 Muharrem 61h).

BIOGRAFIA E HUSEJNIT R.A. – PJSË E HISTORISË ISLAME

Biografia e Husejnit r.a. paraqet një pjesë të rëndësishme të historisë së ummetit tonë. Ai është edukuar në shtëpinë e të Dërguarit a.s., nga i cili edhe trashëgoi moralin e tij fisnik. Moshën madhore e arriti gjatë hilafetit të Ebu-Bekrit r.a. dhe ka prezentuar në luftërat, të cilat i ka zhvilluar ky halif kundër renegatëve të islamit (murtedëve), të cilët i ka thyer plotësisht, dhe e ka kthyer autoritetin e shtetit islam. Më pastaj përjeton fitoret madhështore të ushtrisë islame gjatë kohës së hilafetit të Omerit r.a. dhe është dëshmitar në vrasjen e këtij as'habi – shehidi, nga ana e të mallkuarit Ebu-Lu'lu Mexhusi, adhures i zjarrit i ardhur nga Persia. Pas kësaj, Husejni r.a. përjeton periudhën e përhapjes së da'wes (thirrjes) islame në tërë botën, gjatë kohës së halifit Othman, i cili po ashtu bie shehid, si viktimë e pafajshme e intrigave dhe kompleteve ndaj tij dhe se hipokritët kanë kërkuar mbytjen e tij, e të cilin e mbronin Sahabët. Në mesin e Sahabëve më të njohur që kanë qëndruar në mbrojtje të këtij halifi janë: Abdullah Ibn Zubejr, Abdullah Ibn Omeri, Ebu-Hurejre, Mervan Ibn Hakemi, Husejni dhe vëllai i tij Hasani r.a.. Po ashtu edhe familjet e të gjithë Sahabëve kanë marrë pjesë në mbrojtjen e Othmanit r.a.. Megjithatë, përcaktimi i All-llahut xh.sh. duhej plotësuar dhe Othmani r.a. e refuzon ofertën e tyre për mbrojtje, duke thënë se nuk e dëshiron takimin me Zotin e tij, kur për të derdhet gjaku i pafajshëm i muslimanëve. Othmani r.a. është vrarë dhe është nga shehidët e parë të martirizuar,

pas formimit të shtetit islam. Pas vrasjes së Othmanit r.a., qendra e hilafetit bartet nga Medina në Kufë dhe halif emërohet babai i Husejnit, (dhëndërrri i Pejgamberit a.s.) Aliu r.a.. Husejni r.a. është dëshmitar okular i trazirave që lindën gjatë kohës së hilafetit të babait të tij, me ç'rast është zhvilluar lufta “rreth devës” dhe krijohet një ngatërresë e madhe që rezulton me formimin e grupit Harixhi (të dalurit, të larguarit). Kriminelët në asnjë moment nuk janë hamendur rreth vrasjes së këtij halifi edhe përkundër dashurisë së tij të lartë në zemrat e muslimanëve për shkak të trimërisë së tij në luftën kundër kufrit dhe shirkut. Kur muslimanët i janë betuar për besnikëri dhe bindje Hasanit r.a., Husejni r.a. qëndron afër tij deri në abdikimin e tij nga hilafeti në favor të Sahabiut, Muavi Ibn Ebi-Sufjanit r.a.. Muslimanët janë bashkuar përsëri dhe zemrat e tyre prapë kanë rrahur si të jenë një dhe pas provimeve të gjata dhe të mëdha edhe ishin si një trup. Ai vit është i njohur si vit i unitetit (Aamul-xhema). Pas vdekjes së Muaviut në krye të shtetit islam vie i biri i tij, Jezidi, në kohën e sundimit të të cilit ndodhin shumë trazira dhe ngatërresa, madje edhe vetë Husejni r.a. vritet gjatë kësaj kohe. Jeta e Husejnit r.a. është e mbushur me ngjarje të ndryshme, të cilat paraqesin një pjesë mjaft të rëndësishme për historiografinë islame.

VIRTYTET E HUSEJNIT R. A.

Transmeton Buhariu në “Sahihun” e tij se Ibn Ebi-Nuajmi ka dëgjuar kur është pyetur Abdullah Ibn Omeri për një njeri, i cili e ka mbytur një mizë duke qenë në ihram?! Abdullahu në këtë është përgjigjur: “O banorët e Irakut, po më pyetni për një mizë të mbytyr, kurse ju jeni ata që e keni mbytur nipin e Pejgamberit a.s.!” Transmeton Berau r.a. se Pejgamberi a.s. ka shiquar Hasanin

dhe Husejnin dhe ka thënë: “O Zoti im, me të vërtetë unë i dua ata, të lutem duaji edhe Ti” (Tirmidhiu). Ebu-Seid el-Hudrij r.a. transmeton se Pejgamberi ka thënë: “Hasani dhe Husejni (r.a.) janë prijësit e rinisë në Xhennet” (Tirmidhiu). All-llahu i Lartësuar thotë: “...All-llahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të largojë ndytësinë e mëkateve dhe t’ju pastrojë deri në skaj.” (El-Ahzabë: 33). Ummi-Selemja ka thënë: “Kur është shpallur ky ajet, i Dërguari a.s. e hodhi pelerinën e tij mbi Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Husejnin r.a. dhe tha: “O Zoti im, kjo është familja ime, largoi ata nga mëkatet dhe pastroj plotësisht”.(Tirmidhiu). Ibn-Tejmijje thotë: “All-llahu i Lartëmadhërishtëm na ka sqaruar se ka fshirë mëkatet nga familja e Pejgamberit dhe i ka pastruar plotësisht, për këtë edhe Pejgamberi a.s. e ka lutur All-llahun për anëtarët më të afërt të familjes së tij: Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Husejnin r.a. të parët e rinisë së xhennetit. All-llahu i Lartësuar e ka pastruar familjen e Pejgamberit dhe i ka pranuar lutjet e Pejgamberit a.s. për ta. Rezultat i kësaj është pastrimi nga mëkatet dhe plotësimi i dhuntisë së All-llahut xh.sh., të cilën nuk mund ta fitojnë vetëm me fuqinë dhe imanin e tyre, sepse po të ishte kështu, lutja e Pejgamberit a.s. do të ishte e panevojshme.” (“Hukuku ehli-bejt”, f. 24).

AMANETI I PEJGAMBERIT A.S.

Nga Zejd Ibn Erkami transmetohet se ka thënë: “Një ditë, u ngrit i Dërguari i All-llahut dhe na mbajti një fjalim te një ujë që quhet “Humma” në mes të Mekës dhe Medinës, e falënderoi dhe e lavdëroi All-llahun, pastaj na këshilloi dhe na qortoi, e pastaj tha: “O njerëz! Kini kujdes, vërtet unë jam njeri, është gati që të vie i dërguari (meleku i vdekjes) i Krijuesit tim dhe unë do t’i

përgjigjem, andaj po ua lë dy gjëra madhështore: e para është Libri i All-llahut, në të cilin gjendet udhëzimi dhe drita, andaj merreni Librin e All-llahut dhe përmbajuni atij”. Nxiti dhe inkurajoi për Librin e All-llahut e pastaj tha: “Dhe familja ime; ua përkujtoi (ua tërheq vërejtjen) All-llahun për familjen time, ju përkujtoj All-llahun për familjen time!” Atëherë një nga të pranishmit pyeti: “E kush janë familja e tij, o Zejd? U përgjigj: “Të gjithë ata që u është ndaluar marrja e sadakasë pas tij janë të familjes së tij”. Tha: “E kush janë ata?” Tha (Zejd): “Ata janë familja e Aliut, familja e Akilit, familja e Xhaferit dhe familja e Abbasit”. Tha: “Të gjithë këtyre u është ndaluar marrja e sadakasë?” Tha: “Po” (Muslimi).

EBU-BEKRI, OMERI, OTHMANI DHE ALIU KANË SHFAQUR NDERIMET E THELLA NDAJ FAMILJES SË PEJGAMBERIT A.S.

Dy as’habët më fisnik, Ebu-Bekri dhe Omeri r.a., i kanë kushtuar vëmendje të veçantë dhe respekt të thellë familjes së të Dërguarit a.s.. Ebu-Bekri r.a. ka thënë: “Më me dashuri e gostis familjen e Pejgamberit se sa të mbajë lidhjet me farefisin tim”. Gjithashtu ka thënë: “Respektoni Pejgamberin, duke respektuar familjen e tij” (Buhariu).

Kur flasim për këtë kemi edhe shembullin e Abdullah Ibn Omerit se si e nderon Husejnin r.a., transmeton Junus Ibn Ebi-Is’haku se Ibn-Harbi ka thënë: “Derisa Abdullah Ibn Omeri qëndronte nën hijen e Qabes, pranë tij kalon Husejni r.a., kur e sheh Abdullahu i thotë: “Në

mesin e gjithë banorëve të tokës, ky është personi më i dashur i banorëve të qiellit”. (Ibn-Haxher el-Askelaniu “el-Isabe fi temjizis-sahabe”,-vëll. 4, f. 444).

MUAVIU R.A. KA PASUR RESPEKT TË THELLË PËR HASANIN DHE HUSEJNIN

Kur Muaviu r.a. është bërë halife i shtetit islam, Hasani r.a. dhe Husejni r.a. vazhdimisht e vizitonin dhe ai i priste si askë më parë. Madje njëherë u ka dhënë 200.000 dirhemë për një ditë. Kur është vrarë Hasani r.a., Husejni r.a. vetë e vizitonte Muaviun r.a., i cili edhe më tej e nderonte si mik të veçantë. Husejni r.a. ka qenë në radhët e ushtrisë, e cila ishte nisur për çlirimin e Konstantinopojës në vitin 51 h.. Në këtë ushtri ishte edhe Jezidi, i biri i Muaviut r.a..

Muaviu para se të vdes, e thërret të birin e tij, Jezidin dhe e ka këshilluar me këto fjalë: “Kujdesu për Husejnin, të birin e Aliut dhe të Fatimes (bijës së Pejgamberit a.s.). Ai është më i dashuri te njerëzit. Mbjalidhje të mira me të dhe sillu mirë ndaj tij dhe ai do të sillet mirë ndaj teje. Kujdesu që të mos i ndodhë ndonjë gjë, dhe dëshirë e imja është të hakmirresh për vrasjen e babait dhe vëllait të tij!” (Ibn-Kethiri “el-Bidaje ve nihaje”– vëll. 8, f. 162).

HUSEJNI R. A. SI TRANSMETUES I HADITHEVE

Husejni r.a. ka transmetuar edhe hadithe nga gjyshi i tij, Muhammedi a.s.. Fatimja e bija e Husejnit r.a. transmeton hadithin, të cilin babai i saj e kishte dëgjuar nga Pejgamberi a.s.: “Cilindo musliman që e godet ndonjë fatkeqësi dhe ai e largon atë nga vetja (duke e falënderuar All-llahun), All-llahu do ta shpërblejë si atë ditë kur ajo fatkeqësi e ka goditur” (Ahmedi, Ibn-Maxhe dhe Ebu-Ja’la). Ibn-Tejmije kur komenton këtë hadith thotë: “Transmetimi i këtij hadithi nga Husejni dhe e bija e tij është argument i qartë (islam), për arsye se e bija e tij ishte dëshmitare e vdekjes së tij. Fatkeqësia që përmendet në këtë hadith është pikërisht ajo që e goditi Husejnin r.a.; dhe ai ishte i qetë ndaj saj, sepse qysh më herët e ka ditur se çka po i përgatitet, e sikur të kishte mundësi për ta larguar, ai edhe do të bënte këtë, duke patur parasysh hadithin e lartpërmendur. Është e ndaluar që njerëzit gjatë fatkeqësive dhe mynxyrave të vajtojnë apo kukasin, apo femrat t’i nxjerrin flokët. Pejgamberi a.s. është i pastër nga ata që veprojnë në këtë mënyrë. All-llahu dhe i Dërguari i Tij i urrejnë veprat e këtilla”. (“Minhaxhus-sunneti en-nebewije”-vëll. 4, f. 55).

Dijetari i njohur islam, Ibn-Kethiri thotë: “Kur i është dhënë betimi për besnikëri Jezidit gjatë jetës së Muaviut, Husejni, Abdullah Ibn Omeri, Abdurrahman Ibn Ebi-Bekri dhe Ibn-Abasi kanë qenë nga ata që nuk deshën të japin betimin. Abdurrahman Ibn Ebi-Bekri r.a. edhe vdes duke qenë konsekuent ndaj qëndrimit të vet. Kur ndërron jetë Muaviu, atëherë Abdullah Ibn Omeri dhe Ibn-Abasi i japin betimin Jezidit. Kjo ka ndodhur në vitin 60 h. Husejni dhe Ibn-Zubejri r.a. kanë mbetur në qëndrimin e tyre të mëhershëm dhe braktisin Medinën e shkuan në Mekë”. (Ibn-Kethiri “el-Bidaje ve nihaje”,- vëll. 8, f. 151).

BANORËT E IRAKUT KËRKOJNË ARDHJEN E HUSEJNIT R.A. NË KUFE

Pas ardhjes se Husejnit në Meke, atij i arrijnë disa letra dhe porosi përmes të cilave irakianët kërkojnë nga ai ta lëshoj Mekën dhe t'u bashkohet atyre në Kufe, banorët e të cilit do t'i betohen në besnikëri, në vend se t'i betohen Jezidit. Djali i axhës së Husejnit, Akil Ibn Ebi-Talibi i dërgon në Irak njerëzit e tij, për t'u vërtetuar në sinqeritetin dhe qëllimet e mira të irakianëve, e nëse është e vërtetë ajo që kanë kërkuar, atëherë ai do të përgatitë Husejnin r.a. dhe familjen e tij për t'i dërguar në Irak.

AS'HABËT MË TË NJOHUR E KËSHILLOJNË HUSEJNIN QË MOS TA LËSHOJË MEKËN

Kur as'habët dëgjuan se Husejni r.a. mendon ta lëshojë Mekën dhe të shkoj në Irak, shkuan tek ai për ta këshilluar që një gjë të tillë të mos e bëjë dhe i përkujtuan se çka irakianët i kishin bërë babait dhe vëllait të tij. Transmetohet se Ibn-Abbasi ka thënë: “Husejni më pyeti se çka mendoj për shkuarjen e tij në Irak, unë i thash: “Të mos ishte prestigji ynë që e kemi te njerëzit, tani do të të kapja për flokësh dhe kurrsesi nuk do të lejoja të shkosh atje”. Husejni r.a. në këtë më është përgjegjur: “Më me dëshirë do të vdisja jashtë Mekës se sa në të”. Ibni-Abbasi thotë: “Këto fjalë më detyruan që të mos i flas më për këtë”. Ebu-Minhefi transmeton se Ibni-Abbasi ka shkuar te

Husejni r.a. dhe kur e ka parë se po përgatitet për rrugë, i ka thënë: “Biri im, njerëzit po flasin se ke ndërmend të shkosh në Irak, dëshiroj që ti të më tregosh për këtë?” Husejni r.a. i përgjigjet: “Mendoj të shkoj brenda këtyre dy ditëve insha-All-llah”. Në këtë Ibni-Abasi i thotë: “Dëgjo mirë! Nëse e kanë likuiduar prijësin e tyre të dobët, kanë ngadhnyer armikun dhe në tërësi kanë rregulluar gjendjen e tyre shoqërore, atëherë shko tek ata. Mirëpo, nëse prijësi i tyre është ende gjallë dhe ende i maltreton, dhe nëse bashkëmendimtarët e tij ende janë kryesorë, atëherë dije se të kanë thirrur në ngatërresa, në tollovi dhe në konflikt të padrejtë, në të cilin do të të fusin dhe do t’i ngrisin njerëzit kundër teje, e atëherë ata që të kanë thirrur do të bëhen armiq të e tu”. Husejni r.a. i është përgjegjur: “Do të fali namazin e zgjedhjes (salatul-istihare) dhe si të bëhet!”

Ismail Ibn Salim el-Esedijju transmeton nga Sha’biu se Abdullah Ibn Omeri ka dëgjuar se Husejni r.a. është nisur për në Irak. Abdullahu është nisur menjëherë pas tij, dhe pas tri ditësh e ka takuar dhe e ka pyetur: “Ku je nisur?”, “Në Irak”- përgjigjet ai. Atëherë Abdullahu i merr dhe i shiqon letrat dhe porosinë që i kishin ardhur Husejnit nga Iraku dhe i thotë: “A janë këto letrat e tyre?” “Po”- i përgjigjet Husejni, “Mos iu përgjigj!”- i thotë Abdullahu. Mirëpo pasi që Husejni r.a. ishte i vendosur në mendimin e tij, Abdullahu i thotë: “Do të tregoj një ngjarje të Pejgamberit a.s.: I erdhi Xhibrili të Dërguarit a.s. dhe i tha të zgjedhë ndërmjet kësaj bote dhe ahiretit, dhe i Dërguari a.s. e zgjodhi ahiretin. Ti je pjesë e të Dërguarit dhe për All-llahun, e tërë ajo prej të cilës All-llahu u ka kursyer është për të mirën tuaj (o familje e Pejgamberit a.s.)!” Husejni r.a. përsëri e refuzon këmbënguljen e Abdullahut. Më në fund Abdullahu e përqafton duke qarë dhe i thotë: “All-llahu të ndihmoftë o shehid!” Transmetohet se Ebu-Seid el-Hudriu r.a. ka thënë: “Husejni ishte këmbëngulës në shkuarjen e tij në Irak dhe unë një herë i pata thënë: “Kij dro All-llahun, rri në shtëpinë tënde dhe mos u ngrit kundër imamit (prijësit) tënd!”

Transmetohet se Ebu-Vakid el-Lejthi r.a. ka thënë: “Kam dëgjuar se Husejni r.a. mendon të shkojë në Irak. Kur e kam takuar e kam lutur në All-llahun të mos e lëshojë Mekën, sepse shkuarja e tij në Irak do të ishte një gabim fatal, por ai është nisur duke e ditur se do ta vrasin, dhe ka thënë: “Unë nuk kthehem!” Xhabir Ibn Abdullahu r.a. thotë: “I jam drejtuar Husejnit me këto fjalë: Frikësoju All-llahut dhe mos i përçaj njerëzit, për All-llahun kjo që vepron, nuk është e drejtë!”

Se’id Ibn Musejjebi thotë: “Më mirë do të ishte për Husejnin të mos shkonte (në Irak)”.

Ebu-Seleme Ibn Abdurrahman thotë: “Husejni duhej të dinte se çfarë janë banorët e Irakut dhe pikërisht për këtë nuk duhej të shkonte. Megjithatë, në këtë e ka nxitur Ibn-Zubejri r.a.”. Musewwer Mahremi e ka porositur Husejnin: “Ruaju nga ato letra të irakianëve që të mos të shkatërrojnë”. Me një rast Bekër Ibn Abdurrahmani i ka thënë Husejnit “Biro, a nuk e ke parë se çfarë i kanë bërë irakianët babait dhe vëllait tënd (i kanë mbytur), kurse ti tani dëshiron të shkosh tek ata, ndonëse ata janë robër të kësaj bote! Kundër teje do të luftojnë ata që të janë betuar në besnikëri dhe do të të lënë në mëshirën e atyre, te të cilët je më i dashur se ata që u ndihmojnë. Të lus në All-llahun, mos shko!” Husejni r.a. i është përgjegjur: “O Axha im, All-llahu të shpërbleftë me çdo të mirë, le të bëhet ashtu siç e ka caktuar All-llahu”. Me të dëgjuar këto Bekri i ka thënë: “Ne jemi të All-llahut dhe te Ai do të kthehemi, o babai i Abdullahut (Husejn), All-llahu na ndihmoftë atë ditë kur do të vritesh!” Abdullah Ibn Xha’feri i ka dërguar Husejnit letër me anën e së cilës ia ka tërhequr vërejtjen të mos shkojë në Irak. Përgjigjja e Husejnit ishte “E kam parë ëndërr të Dërguarin a.s., i cili më ka urdhëruar të ndërmarr diç dhe për këtë nuk do ta lajmëroj askë, derisa të mos i shoh veprat e mia (tek All-llahu në ahiret)”.

HUSEJNI R.A. E DËRGON AXHËN E TIJ NË IRAK

Pas letrave të shumta që i vinin nga Iraku, Husejni r.a. e dërgon axhën e tij, Muslim Ibn Akil Ibn Ebi-Talibin në Irak që të shikojë gjendjen e atjeshme. Njëkohësisht, nëpërmjet tij u dërgon letër irakianëve, ku si përfaqësues – vali të tij e emëron sahabiun Nu'man Ibn Beshirin r.a.. Kur Muslim Ibn Akili arrin në Irak, së pari e viziton Muhtar Ibn Ebi-Ubejdin eth-Thekafiun, pas tij shkon te Hani Ibn Urvete. Kur dëgjojnë banorët e Kufës për ardhjen e përfaqësuesit të Husejnit, menjëherë mbliidhen që të gjithë, afër 12. 000, veta dhe i japin besën, duke patur parasysh se ai ishte përfaqësues i njeriut që ata e pranonin për prijës. Një njeri, i cili ishte në anën e Jezid Ibn Muaviut i thotë Beshirit: “Ti je një frikacak i nëpërkëmbur, a nuk e sheh se çfarë trazire ke mbjellur?” Beshiri r.a. në këtë i është përgjigjur: “Më mirë për mua është të jem frikacak në të drejtën, se sa trim në lajthitje!” Pas kësaj ky njeri shkon dhe e njofton Jezidin për tërë këtë. Jezidi këshillohet me Serhumin, këshilltarin e tij, i cili i thotë: “Nuk kemi njeri më adekuat për Kufe, se sa Ubejdullah Ibn Zijadin”. Jezidi qysh moti ishte i hidhëruar në Ubejdullahun, por edhe përkundër kësaj i dërgon letër me të cilën e urdhëron të bëhet komandant në Kufe, të gjejë Muslim Ibn Akilin dhe ta likuideojë. (“el-Isabe fit-temjizis-sahabe” - vëll.1, f. 444)

IRAKIANËT TRADHTOJNË HUSEJNI DHE SHFAQIN HIPOKRIZINË E TYRE CINIKE

Në ndërkohë Muslim Ibn Akili i mbledh 40.000 luftëtarë të flaktë nga Kufja, të cilët veç i ishin përgatitur kundër Ubejdullah Ibn Zijadit. Mirëpo, Ubejdullahu nuk rri duarkryq, por në pallatin e tij i mbledh përfaqësuesit e tij nga çdo fis të Irakut dhe i thërret në kryengritje kundër Muslimit. Në këtë edhe kishte sukses, sepse të gjithë irakianët ia kthejnë shpinën Muslimit, duke dezertuar nga radhët e ushtrisë së tij, derisa me të mbesin vetëm 500 luftëtar. Pas kësaj dezertojnë edhe 200 të tjerë dhe mbesin 300, të cilët pas pak kohe dezertojnë si të tjerët dhe me Muslimin mbesin vetëm 30 veta, që më në fund e lënë vetëm, dhe Muslimi nuk mund të gjejë asnjë njeri që t'i tregojë rrugën për në shtëpi. Këtë situatë e shfrytëzon Muhammed Ibn Esh'athi, i cili e robëron dhe e dërgon në pallat te Ubejdullahu. Ubejdullahu menjëherë e likuidon e më të edhe Hani Ibn Urveten, pastaj të dy i kryqëzon. Husejni r.a. për këtë asgjë nuk dinte, derisa i afrohet Kadisijses 3 mila. Atje e takon Harb Ibn Jezid et-Temimin, i cili i thotë: “Kthehu, atje pas meje nuk ka mbetur asnjë e mirë!” Husejni r.a. as këtë këshillë nuk e dëgjon, e me të ishte edhe vëllai i Muslimit. Ata bindshëm kishin vendosur të shkojnë në Kufe dhe thanë: “Nuk kthehem, përderisa të mos i realizojmë të drejtat tona, apo të vritemi!” (“el-Bidaje wen-nihaje” – vëll. 8, f. 152)

VRASJA E HUSEJNIT R.A.

Ubejdullah Ibn Zijadi e kishte përgatitur ushtrinë kundër Husejnit. Për komandant e kishte emëruar Omer Ibn Sa'd Ibn Ebi-Vekasin. Husejnin e kanë takuar në vendin e quajtur Qerbela. Ushtria e Omerit i numëronte 45 kalorës dhe 100 këmbësorë. Kur janë takuar, Husejni r.a. i ka thënë duke u përpjekur t'i shmangët konfliktit: “Je i detyruar që të më pranosh njërën nga këto tri gjëra që po t'i kërkoj: ose do të më lejosh të vdes si luftëtar në rrugën e All-llahut (në fushë të betejës kundër pabesimtarëve), ose do të më lejosh të kthehem në Medine, ose do të më lejosh t'i jap betimin Jezid Ibn Muaviut”. Omeri për këtë e lajmëron Ubejdullah Ibn Zijadin, i cili thotë: “Nuk pranoj kurrfarë kushti, përderisa të mos më betohet mua në besnikëri”. Husejni r.a. këtë e refuzon dhe fillon konflikti i përgjakur, me të cilin rast vritet Husejni r.a. së bashku me 17 të rinj nga familja e tij. Vrasës i tij ishte Shemr Ibn Dhul-Xhujushi. Pas kësaj, koka e Husejnit hidhet para këmbëve të Ubejdullah Ibn Zijadit. (“el-Isabe fit-temijizis-sahabe” – vëll. 1, f. 334)

TRANSMETIMET E RREJSHME LIDHUR ME VRASJEN E HUSEJNIT R.A.

Pasuesit e risive (bidateve) dhe dëshirave të tyre transmetojnë tregime të trilluara dhe të rreme për vrasjen e Husejnit r.a., P.sh. disa fraksione shiite thonë se pas vrasjes së Husejnit, Jezid Ibn Muaviu i ka robëruar gratë e tij dhe ka urdhëruar t'i hipin në deve pa asnjë mbulesë!!! Duke i

përgënjeshtuar këto transmetime të rrejshme Ibn Tejmijje thotë: “Ajo që transmetohet për Jezidin është se ai asnjëherë nuk ka kërkuar vrasjen e Husejnit, përkundrazi ka dashur t’i shprehë nderim e respekt ashtu siç e ka këshilluar i ati, Muaviu r.a.. Megjithatë, Husejni r.a. është dashur të zgjedhë: ose t’i betohet në besnikëri Jezidit, ose të heqë dorë nga lufta kundër tij. Kur Husejni r.a. ka kuptuar se irakianët e kanë lënë në baltë, ka kërkuar që të kthehet në Medinë, apo të shkojë te Jezidi dhe t’i japë betimin, apo të vdesë në xhihad kundër kafirave. Këtë nuk ia lejoi Ubejdullah Ibn Zijadi, sepse ka dëshiruar ta robëroj. Husejni r.a. është vrarë si shehid i martirizuar. Kur Jezidi ka marrë vesh për vrasjen e tij është pikëlluar dhe ka filluar të qajë për këtë ngjarje të hidhur”. /Kështu Ibn-Tejmijje e transmeton ngjarjen që flet për vrasjen e Husejnit, duke përgënjeshtuar transmetimet e rrejshme dhe të trilluara. Ky fragment gjindet në veprën e tij të famshme “Minhaxhu-l-Kirameti fi ma’rifetil-imameti” të autorit Ibnul-Mutahher. Libri është përplot gënjeshttra, shpifje dhe fyerje për Ebu Bekrin, Omerin, Aishen dhe Muaviun r.a./.

Transmetohet se kur Jezidi dëgjoi për vrasjen e Husejnit r.a. ka thënë “Mallkimi i All-llahut qoftë mbi të (Ubejdullah Ibn Zijadin), sikur të kishte në afërsi me Husejnin, kurrë nuk kishte për ta vrarë”. Gjithashtu, transmetohet se pas kësaj, Jezidi dërgon familjen e tij në Medinë, që drejtpërdrejt t’i shprehin ngushëllim familjes së Husejnit për vrasjen e tij, mirëpo, edhe përkundër kësaj, Jezidi nuk urdhëroi që vrasësi i Husejnit të dënohet apo të arrestohet”. /Minhaxhus-sunneh” vëll. 4, f. 557/

Ibn-Tejmijje vazhdon: “Sa i përket asaj që ai (Ibnul-Mutahheri) ka thënë se Jezidi i ka robëruar gratë dhe fëmijët e Husejnit r.a. dhe i ka hipur në deve pa mbulesë, duke i denigruar para popullit, kjo është një gënjeshtër dhe shpifje. Muslimanët, falendëruar qoftë All-llahu, asnjëherë nuk kanë robëruar askë nga Benu-Hashimitët (fisi i Pejgamberit s.a.v.s.), e as që ka lejuar ummeti i

Muhammedit s.a.v.s. ndonjëherë një gjë të tillë. Megjithatë, pasuesit e epsheve dhe të dëshirave të tyre më shumë i favorizojnë gënjeshttrat. Ata po ashtu kanë thënë se Haxhxhaxhi ka vrrarë disa të familjes së Pejgamberit s.a.v.s. ... Por Haxhxhaxhi kurrë nuk e ka mbytur ndokë të Benu-Hashimëve, edhe pse ka mbytur shumë të tjerë”. /Minhaxhus-sunneti en-nebewije” vëll. 4, f. 558/

ÇKA ËSHTË THËNË PËR JEZID IBN MUAVIUN

Ibn-Tejmijje thotë: “Ata që e pasojnë rrugën e drejtë, shprehin respekt të thellë ndaj atyre që këtë e meritojnë, ata të tillët i dojnë dhe u japin të drejtën atyre që e meritojnë. Në këtë mënyrë shprehet respekti ndaj të vërtetës dhe shprehet mëshirë ndaj krijesave të All-llahut xh.sh.. Duke patur këtë parasysh kuptojmë se çdo njeri i ka vetitë e mira dhe të liga. Njeriu duhet lavdëruar për vetitë e mira të tij, kurse për të ligat duhet qortuar, duke u bazuar në to duhet ta dojmë dhe ta urrejmë, për shkak të tyre të shpërblehet apo ndëshkohet dhe ky është besim i Ehlus-Sunnetit dhe Xhemaatit” ...“... nëse këtë komponentë ne e kemi të qartë, atëherë do të kuptojmë se kur flasim për Jezid Ibn Muaviun, është e njëjtë si kur flasim për cilindo sundimtar apo mbret të kohës së shtetit islam. Kush i dëgjon në gjërat e dashura tek All-llahu, siç janë: namazi, haxhxhi, xhihadi, urdhërimi në të mirë dhe largimi nga e keqja, zbatimi i të drejtës diskrecionale etj. duke iu nënshtruar All-llahut dhe të Dërguarit të Tij. Kështu kanë vepruar besimtarët e parë të drejtë, siç janë Abdullah Ibn Omeri dhe të ngjashëm me të. Por, kush qëndron afër këtyre sundimtarëve dhe mbretërve duke qenë hipokrit, atëherë ai u ndihmon atyre në mëkat e dhunë dhe meriton

ndëshkimin dhe qortimin. Për këtë edhe sahabët ishin në radhët e ushtrisë së Jezidit kur ai organizoi ekspeditën ushtarake në Konstantinopojë, qysh në kohën e Muaviut. Në atë ushtri ishte edhe Ebu-Ejjub el-Ensari r.a.. Kjo ishte ushtria e parë islame që kishte synuar çlirimin e Konstantinopojës”. /“Minhaxhus-sunneti en-Nebevijje” -vëll. 4, f. 544/

Transmeton Buhariu në Sahihun e tij, në kaptinën e xhihadit dhe ekspeditave ushtarake, hadithin nga Ubade Ibn Samiti r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ushtria e parë e ummetit tim e cila nisët në luftë detare e ka meritur (Xhennetin)”. Ummi-Harami i tha: “O i Dërguari i All-llahut, a do të jem edhe unë me ata?”. “Jo”, - i përgjigjet Pejgamberi s.a.v.s..

“Megjithatë dikush do të pyet se a është e lejuar që të mallkohet Jezidi sepse ai e ka mbytur Husejnin, ose së paku ka urdhëruar që të mbytet!? Në këtë pyetje përgjigjet dijetari i njohur islam Ebu-Hamid el-Gazali, i cili tha: “Nuk është lejuar të thuhet se ai e ka mbytur, sepe kjo nuk është e vërtetuar, andaj nuk lejohet mallkimi i tij, sepse asnjë musliman nuk guxon të akuzohet për mëkat të madh, pa ekzistimin e fakteve relevante për këtë. Normalisht, lejohet të thuhet se Ibn-Mulxhemi e ka mbytur Aliun r.a., apo Ebu-Lu’lu el-Mexhusi e ka mbytur Omerin r.a., sepse për këtë ekzistojnë argumentet. Nuk guxojmë ta akuzojmë muslimanin për kufr dhe dexhenerim, e për këtë të mos kemi argumente të forta. I Dërguari s.a.v.s. ka thënë: “Nëse dikush e quan tjetrin kafir, apo fasik, e ai nuk ë i tillë, atëherë ato fjalë do kthehen tek ai që i ka thënë!” / Buhariu, Muslimi/. Gazaliu më tej vazhdon: “A është e lejuar të thuhet: Mallkimi i All-llahut qoftë mbi vrasësin e Husejnit?” Ne në këtë përgjigjemi, është e lejuar të thuash: Mallkimi i All-llahut qoftë mbi vrasësin e Husejnit nëse nuk është penduar para vdekjes, sepse është e mundur të ketë vdekur pasi të jetë penduar, si p.sh. Vahshiu e ka mbytur xhaxhain e Pejgamberit, Hamzën r.a., derisa ishte pabesimtar, pas kësaj ai pranon islamin dhe pendohet për të gjitha mëkatet dhe vrasjet

që kishte bërë, e nuk lejohet mallkimi i tij. Vrasja është mëkat i madh, por nuk e arrin shkallën e kufrit edhe nëse nuk pendohet për të (vrasësi), atëherë mallkimi i tij është një gjë shumë e madhe (për imanin e mallkuesit, që nuk e din se a është penduar apo jo). Në këtë rast më mirë është të heshtët”. Me mallkuar muslimanin e pafajshëm, është ngjashëm sikur me e mbytur. I Dërguari s.a.v.s. ka thënë: “Mallkimi i muslimanit është i ngjashëm me mbytjen e tij”! /Buhariu, Muslimi/

HISTORIA E RREJSHME DHE E MVESHUR

Ka shumë historianë “islam” që i kanë shtrembëruar disa fakte historike, jo vetëm të jetëshkrimit të Husejnit r.a.. Në ato libra zakonisht përmendet se Jezid Ibn Muaviu e ka sulmuar Medinën dhe i ka mbytur të gjithë anëtarët e familjes së Pejgamberit s.a.v.s., i ka robëruar gratë e tyre, ka vrarë 700 muhaxhirë dhe ensarë dhe me mijëra banorë të tjerë, kurse Medina e tëra ishte e mbuluar me gjak, i cili e kishte përfshirë edhe varrin e Pejgamberit s.a.v.s.. Poashtu në këto libra ceket edhe ajo se Jezidi ka urdhëruar që të shkatërrohet Medina me katapult dhe pas kësaj e ka djegur dhe e ka rrënuar atë!!!

Përgjigjen në këto shpifje dhe gënjeshtra ia lëmë dijetarit eminent Ibn-Tejmijjes, i cili tha: “Kur banorët e Medinës bënë shfuqizimin e besnikërisë ndaj Jezidit (si shkak i vrasjes së Husejnit r.a.), dhe dëbuan përfaqësuesit e tij nga Medina, ai disa herë ka dërguar delegacione për të kërkuar nga ata që të vazhdojnë në besnikëri. Atëherë dërgon Muslim Ibn Ukbete el-Merrinë dhe e urdhëron që tri ditë të veprojnë në Medine si të dojë! Për këtë edhe duhet të kritikohet Jezidi më së shumti.

Pikërisht për këtë kur është pyetur Imam Ahmedi se a i pranon hadithet e transmetuara nga Jezidi, ai ka thënë: “Jo, a nuk është ai që ka vepruar me Medinën, atë që ka vepruar”! Megjithatë, edhe përkundër kësaj ai nuk i ka mbytur tërë anëtarët e familjes së Pejgamberit, numri i të vrarëve nuk ishte me mijëra dhe gjaku i derdhur nuk e ka mbuluar varrin e Pejgamberit s.a.v.s., e as që është derdhur gjak brenda xhamisë së Pejgamberit. Sa i përket Qabes, All-llahu i Lartë e ka ruajtur edhe para ritrajtësimit të islamit e edhe pas tij, dhe askush nuk ka arritur ta shkatërrojë. Përkundrazi, para ritrajtësimit të islamit, kur në vitin e elefantit kanë dashur ta rrënojnë, All-llahu i Lartë i ka dënuar me dënimin e tij të rëndë: “A nuk e ke parë se ç’bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit?” /el-Filë: 1/... “S’ka dyshim se ata të cilët nuk besuan dhe pengojnë prej rrugës së All-llahut dhe prej xhamisë së shenjtë (Qabes), të cilën Ne e bëmë të barabartë për njerëz, qofshin vendas ose të ardhur, dhe, kushdo që të përpiqet të bëjë ndonjë të keqe a ndonjë mëkat, Ne kemi për t’ua shijuar një dënim të idhët.” /el-Haxhxh: 25/

Është e njohur se sektet Keramite dhe Batinije janë më së shumti në kufr, nga të gjitha sektet tjera. Ata i kanë mbytur haxhinjtë dhe i kanë hudhur në pusin e Zemzemit dhe pas kësaj e kanë vjedhur Haxherul-Esvedin, i cili për një kohë të gjatë ka qendruar tek ata. Por edhe përkundër tërë kësaj nuk kanë mundur t’i bëjnë Qabes asgjë, edhe pse atëherë ishin pabesimtarë më të mëdhenj. Sa u përket sundimtarëve Emevij dhe Abasij, ata asnjëherë nuk kanë patur për qëllim ta rrënojnë Qaben, madje as mëkëmbësi i Abdul-Melikut, Haxhxhaxh Ibn Jusufi. Ata e kanë rrethuar Ibn-Zubejrin dhe e kanë goditur me katapult atë, e jo Qaben. Jezidi nuk e ka shkatërruar Qaben e as nuk ka patur për qëllim ta djegë, as ai, e as ushtria e tij. Rreth këtij fakti pajtohen të gjithë muslimanët. Ibn-Zubejri e ka rrënuar Qaben, por me qëllim që ta ndërtojë në mënyrën të cilën Pejgamberi s.a.v.s. ia ka përrshkuar Aishes r.a. Zjarri (gjatë konfliktit) ka përfshirë mbulesën

e Qabes dhe nga nxehtësia kanë pëlcitur gurët e murit. Abdul-Meliku e ka urdhëruar Haxhxhaxhin që ta riparojë në formën që ka qenë në kohën e Muhammedit s.a.v.s.. Haxhxhaxhi gjatë riparimit e ka ngritur lartësinë e mureve, me të cilën gjë është pajtuar edhe Abdul-Meliku...” /“Minhaxhus-sunneti en-nebewije”, vëll. 4, f. 575-578/. “Katapulti është përdorur në ato raste kur përveç tij nuk ka patur mundësi përdorimi asnjë lloj arme tjetër, siç e ka përdorur katapultin Pejgamberi s.a.v.s. për t’i goditur banorët e Taifit, kur ata kishin ngritur barrikada para kështjellave të tyre. Kur Ibn-Zubejri, me bashkëlufetarët e tij kishin ngritur barrikada përreth Qabes, Haxhxhaxhi i ka goditur me katapult. Pas vrasjes së Ibn-Zubejrit, ushtria e Haxhxhaxhit ka hyrë në Qabe dhe e ka bërë Umren, duke bërë tavaf rreth Qabes (të cilën nuk e kanë rrënuar). Po atë vit Haxhxhaxhi e kryen haxhin dhe Abdul-Meliku e urdhëron që të mos e kundërshtojë Abdullah Ibn Omerin rreth rregullave të haxhit. Sikur të dëshironin ata që ta rrënojnë Qaben, këtë do ta bënin pas hyrjes në Mekkë, pas vrasjes së Ibn-Zubejrit...” /“Minhaxhus-sunneti en-nebewije”, vëll. 4, f. 584/.

Do të sjellim edhe një shembull të distorcionit historik që është lansuar te muslimanët e padijshëm dhe naivë. Një ngjarje e cila vazhdimisht përsëritet në gjuhët e ndryshme të muslimanëve, çka është edhe më e rëndë një gjë e tillë përsëritet edhe në medresetë tona nga ana e “ekspertëve” të historisë islame. Në disa vepra historike qëndron se dy sahabë kanë arbiruar për konfliktin në mes të Aliut dhe Muaviut r.a.. Përfaqësues i Aliut ishte Ebu-Musa el-Esh’ari, kurse përfaqësues i Muaviut ishte Amr Ibn el-As r.a.. Transmetimi i rrejshëm është kur thuhet se Amr Ibn el-Asi i ka thënë Ebu-Musës: “Fol ti i pari”! Atëherë, Ebu-Musa i thotë: “Kam menduar mjaft, dhe kam vendosur ta braktis Aliun. Do të hjek shpatën dhe do të vendosi para muslimanëve të grumbulluar, kurse edhe ti vepro kështu!” Dhe kështu mirren vesh. Kur dalin

para masave, Ebu-Musa vepron sipas skenarit të mëparshëm. Kur vie radha tek Amri ai thotë: “Unë kam menduar mjaft dhe kam vendosur të qëndroj në anën e Muaviut, çka e verteton edhe shpata ime!” Ebu-Musa befasohet dhe don ta kundërshtojë, por Amri i thotë: “Kështu jemi marrë vesh”. Dhe kështu muslimanët edhe më shumë u përçanë dhe lindi një konflikt dhe mosunitet edhe më i madh!!!

Ja pra historianët fantomë i paraqesin sahabët e të Dërguarit si gënjeshtarë, mashtruesi dhe intrigantë të mëdhenj. Imam Ebu-Bekr Ibn el-Arebi duke i përgënjeshtuar këto transmetime thotë: “Kjo është një gënjeshtër dhe trillim, sepse asgjë nga kjo nuk ka ndodhur. Këto janë transmetime që i tregojnë ata që i pasojnë risitë (bidatet) dhe trillojnë një histori të re të sunduesve dhe mbretërve. Këto trillime i kanë përcjellur të marrët dhe mëkatarët, njëri nga tjetri, duke bërë kështu mëkat ndaj All-llahut të Lartë...” /El-Awasimu minel-kawasim” f. 177/.

“Një gabim fatal, të cilin e bëjnë historianët nga padija është ai se në kohën e hilafetit të Aliut r.a., Muaviu r.a. nuk ka qenë halif dhe as që ka kërkuar një gjë të tillë, pra si të kërkohej nga Amri që të bëjë shfuqizimin e besnikërisë!? Amri dhe Ebu-Musa çështjen e hilafetit e kanë lënë nën juridiksionin e sahabëve që ende ishin gjallë dhe në mesin e tyre, e me të cilët i Dërguari s.a.v.s. ishte i kënaqur. Marrëveshja e këtyre dyve nuk ka përfshirë Muaviun në asgjë, sepse ai nuk ishte halif dhe nuk luftonte për një gjë të tillë. Muaviu vetëm kërkonte që të arrestohen dhe të dënohen të gjithë ata që kishin marrë pjesë në atentatin kundër Othmanit r.a. Megjithatë kur ka lind pyetja për udhëheqjen e shtetit islam, atëherë këta dy sahab, gjykimin për këtë ua kanë lënë sahabëve të mëdhenj. Udhëheqja e shtetit islam ishte çështje kryesore në dialogun e tyre. Sa i përket qëndrimit të këtyre dy sahabëve, edhe përkundër administrimit të rregullimit të brendshëm dhe udhëheqjes së atyre anëve që i përfaqësonin, asnjëri nuk e ka tradhtuar besimin e udhëheqësit të vet... Në

marrëveshjen në mes këtyre dy sahabëve nuk kishte kurrfarë mashtrimi apo intrige dhe asnjëri nuk kanë qenë të pakujdesshëm ndaj tërë kësaj çështje. Amr Ibn el-Asi nuk ka shpallur se Muaviu është bërë prijës i muslimanëve dhe se hilafeti i takon atij. Po ashtu, as Muaviu këtë asnjëherë nuk e ka thënë, sepse ai ka marrë hilafetin vetëm pas marrëveshjes dhe pajtimit me Hasanin, të birin e Aliut r.a.” /Muhibbudin el-Hatib “Sherhul-awasimi minel-kawasimi” – f. 174-175/.

PËRSHKRIMI I HISTORISË ISLAME

Historiani i njohur islam bashkohorë Muhammed Shakir thotë: “Historia i bërë padrejtësi të madhe Emevive, sepse në të nuk përmendet pothuaj asnjë shërbim i tyre që e kanë bërë për shtetin islam. Përkundrazi, historia vetëm i ka degraduar, duke përmendur vetëm vetitë negative të tyre, dhe duke ua mveshur atë që nuk e kanë bërë. Vlen të përmendet se ato libra historike në të shumtën e rasteve, janë shkruar në kohën e konflikteve të tyre politike me Abasitët, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, tërë këto libra janë shkruar nga duart shiite, me plot urrejtje ...” /“Tarihul-Islami” vëll. 4, f. 50/.

“Megjithatë, në mesin e dijetarëve muslimanë ka historianë që kanë shkruar historinë reale islame dhe besnikërisht e kanë paraqitur atë që vërtet ka ngjarë, rreth temës për të cilën flasim. Në mesin e tyre janë Ibn Ebi-Dunja dhe el-Begavi. Por, edhe përkundër besnikërisë së tyre, në vargjet e transmetimeve ka edhe shumë të dhëna të pavërtetuara dhe jo të vërteta” /“Minhaxhus-sunneti en-nebewije” vëll. 4, f. 556/.

ÇKA KA NDODHUR NË TË VËRTETË

Shumë është shkruar për mënyrën dhe shkakun e vrasjes së Husejnit r.a.. Ka nga ata që atë e kanë ngritur shumë lartë dhe i kanë përshkruar disa cilësi, me të cilat veç kanë ra në shirk. Shejtani këtij grupi të njerëzve u ka shpallur se për Husejnin duhet vajtuar, pikëlluar dhe me thika të goditen fytyrës dhe trupit në ditën e Ashureve. Shejtani gjithashtu u ka shpallur se me sharjen, fyerjen dhe mallkimin e sahabëve të të Dërguarit s.a.v.s., arrijnë grada të larta tek All-llahu i Lartë!! Ata vdekjen e Husejnit, i cili është i pastër nga ta, e tregojnë si tragjedi, e cila natyrisht se është e zbukuruar me gënjeshtër dhe detale nga legjendat satanike. I pari që ka gënjer dhe me shpifjet e tij ka “stolisur” vrasjen e Husejnit r.a. është Muhtar Ibn Ebi-Ubejd eth-Thekafiu.

Nga ana tjetër, disa shiitë në pusi e kanë pritur ndonjë lëshim të dijetarëve islam, në mënyrë që më vonë të bëjnë tregti me gjakun e Husejnit. Të tjerët, madje thonë se Husejni r.a. e ka merituar vdekjen, sepse ka synuar ndarjen e muslimanëve dhe është ngritur kundër imamit legal të shtetit islam. Si argument për këtë marrin fjalët e Muhammedit s.a.v.s.: “Me të vërtetë do vijë koha e trazirave dhe risive, andaj kush synon ndarjen e muslimanëve përderisa ata janë të bashkuar ndërmjet vete, goditeni me shpatë, pa marrë parasysh se kush është ai”! /Muslimi/.

Megjithatë, qëndrimi i Ehli-sunnetit për këtë çështje më së miri është treguar përmes fjalëve të Ibn-Tejmijes, i cili thotë: “Sa i përket vrasjes së Husejnit r.a., nuk ka dyshim se është mbytur pa të drejtë dhe është shehid i martirizuar, si edhe ata që ishin në anën e tij dhe me të vdiqën. Vrasja e Husejnit është mëkat i madh dhe mosrespektim i All-llahut dhe i të Dërguarit të Tij... Vrasja e tij paraqet një fatkeqësi për familjen e tij dhe për të gjithë muslimanët e botës. Vrasja e tij për të ka qenë shehadet (është ra shehid)... Ai dhe vëllau i tij tek All-llahu kanë merituar kënaqësinë, e cila

nuk mund të arrihet, përveç me rrugën e sprovave të mëdha, dhe askush nga familja e tij nuk kanë përjetuar atë që ata e përjetuan. Ata dy ishin edukuar dhe rritur në shtëpinë e islamit me plot krenari dhe siguri. Hasanin e kanë helmuar, Husejnin e kanë vranë, për të arritur ata gradat e të kënaqurve dhe jetën e shehidëve të All-llahut”. /“Minhaxhus-sunneti en-nebewije”, vëll. 4, f. 550/ “... por vrasja e tyre nuk paraqet tragjedi më të madhe se vrasja e atyre që ishin më të mirë se ata, siç ishin peygamberët e mëparshëm, sahabët që ranë në Uhud, sahabët që u vranë në luftë kundër Musejlemës, sahabët që u vranë në Bi’rul-Meune, dhe vrasja e Omerit, Othmanit dhe Aliut r.a.. Tragjedi e veçantë ishte vrasja e Aliut, sepse vrasësit e tij e kishin shpallur pabesimtar dhe kanë thënë se vrasja e tij është një nga ibadetet më të mira!!! Ata që e mbytën Husejnin nuk kanë menduar se ai është pabesimtar, dhe është vërtetuar se nuk kanë dashur ta mbysin duke qenë të bindur se kjo është një ndër mëkatet më të mëdha. Megjithatë, atë e vranë për shkak të interesave personale, ashtu siç i mbysin sot njerëzit njëri tjetrin për shkak të pushtetit. Nga kjo shihet se ka transmetime të shumta të rrejshme për vrasjen e Husejnit r.a. siç transmetohet p.sh. se pas vrasjes së tij në vend të shiut ka ra gjak!!! ... Apo se në qiell është lajmëruar një ngjyrë e kuqrrremtë pas vrasjes së tij. Kjo ngjyrë nuk ka kurrfarë lidhje me vrasjen e Husejnit, sepse kjo ngjyrë lajmërohet edhe sot dhe për këtë ekziston shkak i justifikueshëm natyror...” /“Minhaxhus-sunneti en-nebewije”, vëll. 4, f. 599/.

REZYMEJA

Këto janë fakte të vërteta dhe të drejta të historisë islame, larg nga çdo transmetim i rrejshëm dhe i pavërtetë të cilin e kanë shpifur shiitët, sufitët dhe të gjithë ata që ndjekjen e pasioneve dhe risive e bashkojnë me metodat e punës së tyre, duke bërë kështu tregti me gjakun e pastër të Husejnit r.a. Atë që e kemi transmetuar këtu nga dijetarët tanë të njohur, paraqet një informim të vërtetë të mjaftueshëm për besimtarët. Është vaxhib për çdo musliman që të ruajë gjuhën e tij nga diskutimi për këtë trazirë e cila është prapa nesh, ashtu siç ka thënë Omer Ibn Abdul-Azizi: “All-llahu i ka ruajtur duart e mia nga ai gjak, për këtë arsye, nuk dua që me të njëjtin gjak të përlyej gjuhën time”. Omer Ibn Abdul-Azizi këtë deklaratë e ka dhënë pasi i ka kuptuar fjalët e All-llahut të Lartëmadhëruar, ku thotë: “Ai ishte një popull që shkoi, të cilit i takoi ajo që fitoi, e juve ju takon ajo që fituat dhe ju nuk pyeteni për atë që ata vepruan.” (El-Bekare: 141).